



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1299/5 Prot.

Patos, më 21/05 2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 20 MAJ 2026

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetar i bashkisë Patos, znj. Ina Sauli, Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Anëtarë GMS, përfaqësues të bashkisë Patos, me pjesëmarrjen e **21 pjesëmarrësve (banorë, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të shoqatave etj)**

Takimin hapet nga Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj- Të nderuar të pranishëm! Ju



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Tema e kësaj dëgjese është Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027. Kjo dëgjese është

e bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”. Jemi në këtë dëgjese për të marrë kërkesat tuaja lidhur mbi PBA dhe Buxhetin 2027 dhe për të bërë rishqyrtimin e tyre. Do ju lutesha që fjala të merrej me rradhë dhe të prezantoheshit gjatë kërkesave tuaja. Ju faleminderit!

Drejtores e Financës, znj. Mimoza Shtëmbari- Përsëritje! Në dëgjesën e kaluar ku u morën kërkesat fillestare të PBA-së 2027-2029 ju keni kërkuar ndriçimin rrugor, rishikimin e qendrës së qytetit pasi nuk kalojnë dot njerëzit dhe makinat, ka pasur kërkesa për disa banesa për rikonstrukcion nga fondet e bashkisë. Është kërkuar ndërtimi i një tregu ushqimor, pajisje me kosha mbeturinash, parkim publik, ndërhyrje në varrezat e Hoxhallarëve në Kuqar dhe ndërhyrjen në rrugën nga Patosi Lart deri në Oficinë dhe kërkesa të tjera. Sot jemi në një dëgjese tjetër për ti rishqyrtuar edhe njëherë këto kërkesa dhe për të marrë kërkesat e tjera shtesë që mund të keni.



**Drejtores e Financës
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjese publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të PBA-
së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Anëtar i Pleqësisë Dukas Kripallari, z. Sefret Kripa- Përsëritje! Unë kam dy kërkesa. Në fshatin tonë është në moçal ose liqen dhe tani në kohën e verës krijohen mushkonja që mund të sjellin infeksion. Kërkoj të bëhet spërkatja e mushkonjave me ilaç. Para disa kohe u




**Anëtar i Pleqësisë Dukas Kripallari
z. Sefret Kripa**

**Dëgjese publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

bë dhe ura me disa tumbino në Dukas dhe u bë e saktë. Tani kanë hequr tumbinot dhe ura është hapur dhe nuk kalohet dot. Aty nuk kalojnë dot banorët, duhet sistemuar ura në mënyrë që të kalojnë.

Kryetar i fshatit Dukas, z. Sali Çobaj- Kemi disa probleme në fshatin Dukas. Problemi i urës në Dukas që u përmend është i drejtë pasi është problem për banorët për të kaluar. Duhet ti jepte zgjidhje dhe të rregullohet ura. Problematikë tjetër lidhet në lagjen Dukas Çoban te biznesi i Ladimir Golloshit, pasi nuk hyn dot makinat. Është në formë trekëndëshi dhe makinat nuk kthehen dot për poshtë. Kërkoj të rishikohet rruga aty dhe të zgjidhet problemi i kalimit.




**Kryetar i fshatit Dukas
z. Sali Çobaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Kryetar i fshatit Kuqar, z. Islam Shpata- Përsëritet të gjithëve! Duke qënë se kryetari i



**Kryetar i fshatit Kuqar
z. Islam Shpata**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Rusinjës nuk ka ardhur dot sot për arsye shëndetësore, në Rusinjë te Bletët dhe Bardhajt është një rrugë rreth 200 m për shtrim. Është dhe një rrugë tjetër përball shkollës Hekuran Maneku te karburanti rreth 200 m janë ankuar disa banorë, pasi rruga është në gjendje të keqe.

Kryetar i fshatit Rerës, z. Shaban Ruçaj- Përsëritet! Rerësi ka filluar punë dhe është bërë shumë punë. Janë lënë edhe punë pa bërë. Rruga Pajajt që filloi po bën një vit dhe nuk ka mbaruar. Jam i lumtur që filloi dhe rruga “Rrapushaj”. Kemi shumë rrugë të tjera të brendshme të lagjeve të pabëra dhe janë rrugë të shkurtra. Rruga Buzajt është prishur zgara sa hyn te varrëzat tona dhe nuk futesh dot fare, është në gjendje të keqe. Rruga e Zekallarëve po


bën vite që është premtuar, por nuk është bërë. Ndriçimi i rrugës Karemanaj që u bë e re ka ngelur pa vendosur akoma, nuk ka ndriçim. Rruga Ruçaj është pa shtruar që është planifikuar. Është dhe rruga kryesore që lidh Banaj-Rerës që nuk kanë shumë për ndërhyrje, vetëm shtrim duan. Kjo linjë është shumë e nevojshme. Ujërat e zeza është bërë një sesion dhe pjesa tjetër ka ngelur pa bërë.



**Kryetar i fshatit Rerës
z. Shaban Ruçaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”
Maj 2026**

Përfaqësues i shoqatës pensionistëve, z. Bashkim Velçani- Përshëndetje! Unë kam një propozim për çështjen e tregut që është në rrugë dhe shiten në rrugë perimet, frutat. Aty te rruga Koli Marku ku po bëhen punimet sugjeroj të ngrihet një treg për tregtimin e produkteve ushqimore. Kjo është një gjë e mirë edhe për shëndetin tonë si banor që ushqimet të jenë më të kontrolluara.



**Përfaqësues i shoqatës pensionistëve
z. Bashkim Velçani**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”
Maj 2026**

Zv/ Kryetar, znj. Ina Sauli- Tregu ushqimor është planifikuar për tu bërë tregtarët do të kenë hapësirën e tyre për të tregtuar produktet.



**Zv/ Kryetar
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Faslliaj– Përsëndetje! Unë do të doja që dëgjesat publike të mos ishin vetëm në këtë format, në njësi administratove dhe sallën e Këshillit sepse sa herë që kam marr pjesë shiko që vjen një pjesë e vogël e kryetarevë të fshatrave dhe qytetarët pothuajse nuk vijnë fare. Nqse duam të marrim kërkesat reale që qytetarët kanë unë mendoj që duhet të organizojmë dëgjesa në secilin fshat. Problematikat e lagjes Mustafa Matohiti do duhet të kishte një adminbistrator që të trajtonte problematikat e kësaj lagje sepse ka ngelur si një lagje e patrajtuar. Propozoj që herën tjetër të zgjedhim një administrator atje për problematikat që kanë banorët. Infrastruktura rrugore në Margëlliç është problem. Ka vite që kur u bë rruga e Lapidarit dhe është e vetmja rrugë fshati që u bë në atë fshat. Deri në gjysmën e rrugës është asfaltuar rruga dhe ndriçuar. Banorët edhe pse paguajnë ndriçimin, nuk kanë ndriçim. Edhe ato shtylla që janë vendosur gjysmat ndizen. Komplet pjesa e Bregut lart, lagjja e Kalasë, lagjja Faslliaj janë me infrastrukturë rrugore në gjendje të keqe. Në Margëlliç janë tre parcela varrezash dhe vetëm njëra është rrethuar. Dy të tjerat janë pa rrethuar. Duhet dhe mirëmbajtja e rrugëve që të çojnë në varreza pasi janë në gjendje të keqe. Unë do bëj dhe kërkesë në Këshillin Bashkiak që në të destinojmë një fond për rërë bituminoze sepse janë disa fshatra që janë të paaksesueshme për tu shtruar me asfalt dhe do duhet me patjetër rërë bituminoze. Duhet të kemi një pjesë buxheti me rërë bituminoze që ti zgjidhim këto rrugë. Gjithashtu duhet ndriçim në lagjen Mustafa Matohiti në zonën Menxa 3. Janë vendosur shtyllat në anë të rrugës në këtë zonë dhe na duhen vetëm ndriçues. Ajo zonë duhet pastruar pasi hidhen mbeturinat. Kemi dhe rrugët e parcelave sepse mjeti i bashkisë që vjen i ka lënë në gjysëm pa përfunduar.



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Banor i lagjes "29 Marsi", Patos, z. Agim Zenunaj- Unë jam qytetar në lagjen "29 Marsi",



**Banor i lagjes "29 Marsi", Patos
z. Agim Zenunaj**

**Dëgjesë publike me temë:
"Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027"**

Maj 2026

Patos dhe rruga u shtrua dhe është në gjendje të mirë. Tani na ka ngelur pa bërë ujërat e zeza dhe rruga nuk është bërë në mes të lagjes. Bëhet fjalë për rrugën mbi Shtëpinë e Bardhë. Pse mos të shtrohet dhe kjo rrugë pasi është 1 km rrugë. Ju lutem edhe kanalizimet e ujërave të zeza pasi është shumë problem sepse ne jemi akoma me gropa skeptike. Gjithashtu është kanali vaditës dhe është mbushur me ujë të pisët dhe ka krijuar papastërti dhe mushkonja. Duhet pastruar kanali vaditës.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni kërkesa të tjera e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjesë.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
"Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027"**

Maj 2026

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba